



Pranuar / Dorezuar Prijemeno/Prudato Received/Delivered	27-04-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org /Unit	SKPM/SHK	2460/2022	113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.311/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.311/2022 të datës 30.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON Procedimi Administrativ i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.311/2022 të datës 30.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, ka aplikuar për lëvizje brenda kategorisë për pozitën “Zyrtar i lartë për ndërtimtari”, i shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sipas numrit të referencës RN00008020. I pakënaqur me vlerësimin përfundimtar nga komisioni vlerësues, me datën 30.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1683/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 24.03.2022 të lëshuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me

pretendimet ankimore se konkurrentja tjetër në këtë konkurs nuk i ka plotësuar kushtet për të kaluar fazën e parë si dhe ndaj tij vlerësimi në intervistën me gojë nuk ka qenë real.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 06.04.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, konkretisht ushtruesja e detyrës së Udhëheqëses së Divizionit të Personelit me datën 14.04.2022 përmes e-mailit zyrtar ka dhënë përgjigje duke sqaruar që me datën 29.03.2022, ankuesi ka parashtruar ankesën tek ky institucion, ndërsa me datën 01.04.2022 i njëjti e ka tërheq ankesën e tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1683/2022 të datës 30.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 30.03.2022 për qasje në dokumente zyrtare; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 14.04.2022 lidhur me përgjigjen nga ana e ushtrueses së detyrës së Udhëheqëses së Divizionit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e protokolluar me datën 26.04.2022; Emailin zyrtar të datës 01.04.2022 lidhur me tërheqjen e ankuesit në institucionin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit **është bërë i pamundur, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 30.03.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datën 22.04.2022, ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 2336/2022, me të cilën ka deklaruar se e tërheq ankesën e datës 30.03.2022 për arsye personale. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : *“Një procedure administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.311/2022, datë 27.04.2022

Ardija Perguku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- ❖ Arkivat të KPMSHCK-së